VENDIM
Nr. 613, datë 7.7.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 839, DATË 11.12.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 839, datë 11.12.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr. 1, "Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura", që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në lidhjen nr. 2, "Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura", që përmendet në pikën 3, emërtesat "Pilotët e emëruar në pozicione organike që kërkojnë kryerjen e fluturimeve"; "Pilotët e emëruar në pozicione organike që nuk kërkojnë kryerjen e fluturimeve"; "Personeli mirëmbajtës inxhiniero-teknik i aviacionit"; "Personeli fluturues teknik e mekanik."; "Personeli ushtarak i qendrave të vëzhgimit ajror në Forcat Ajrore" shfuqizohen.

c) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3.1 Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët aktivë fluturues të Forcave të Armatosura të jetë sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i të këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2015 dhe fillojnë, përkatësisht:

a) nga data 1 janar 2015, për parashikimin e bërë në pikën 1, shkronja "a";

b) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për parashikimin e bërë në pikën 1, shkronjat "b" dhe "c".

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA

	Vitet e shërbimit														
OFICERË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj. Lejtnant (Admiral)															157000
Gj. Major (Nënadmiral)														147000	150000
Gj. Brigade (Kundëradmiral)													117000	118000	118000
Kolonel (Kapiten i rangut I)											93000	94500	96500	98500	100000
Nënkolonel (Kapiten i rangut II)									74000	75200	76400	77700	78900	80300	81500
Major (Kapiten i rangut III)							58500	59500	60500	61500	63500	64500	65500		
Kapiten (Kapiten lejtnant)				52600	53100	53400	54200	54900	55600	56400	57000				
Toger (Lejtnant)			48600	49900	50800	52100	52600								
Nentoger (Nënlejtnant)	45100	46200	47300	48000	48100	48600									
	Vitet e shërbimit														
NËNOFICERË	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/Kapter											53500	54500	56200	57300	58300
Kapter								45800	47300	48200	49000	50300	52300		
Rreshter						41000	42300	44500	45800	47300	48200				
Tetar				38500	39200	40100	41000	41500	42500	43500	44500				
Nëntetar	33400	34200	35500	36500	38500	40000									
	Vitet e shërbimit														
USHTARË AKTIVË	1 Vit	2	3	4	5	6	Mbi 6								
Ushtar IV/ Detar IV				35700	37300	37900	38500								
Ushtar III/ Detar III			34600												
Ushtar II/ Detar II	32000	33300													
Ushtar I/ Detar I	30500														
STUDENTË	Në muaj														
Kadet, rekrut/kandidat për ushtar	3500														

Lidhja nr. 2/1

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët aktivë fluturues të Forcave të Armatosura

Nr.	Emërtimi i funksionit	Masa e shtesës mujore në lekë për muaj			
		Në skuadroni dhe grupe të helikopterëve në Bazën Ajrore Farkë të Forcave të Armatosura	**Në strukturat e tjera të Bazës Ajrore Farkë të Forcave të Armatosura**	**Në strukturat e tjera të Forcave Ajrore**	**Në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura**
1.	Pilot	40000	30000	20000	10000
2.	Inxhinier fluturimi	28000	21000	14000	
3.	Mekanik/teknik bordi	24000	18000	12000	
4.	Infermier bordi Operator bordi Vinçier bordi	20000	15000	10000	
5.	Inxhinier avioni/helikopteri	16000	12000	10000	
6.	Kontrollor i trafikut ajror	12000	12000	12000	
7.	Teknik avioni/helikopteri	12000	10000	10000	